

SHPALLJE PËR SHPREHJE INTERESI TË KANDIDATËVE TË INTERESUAR PËR T'U ZGJEDHUR SI KOORDINATOR NË INSTITUCIONET PJESË E RRJETIT KUNDËR KORRUPSIONIT

Pranë Ministrit të Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit krijohet dhe funksionon Rrjeti i Koordinatorëve kundër Korrupsionit.

Ky Rrjet i Koordinatorëve kundër Korrupsionit ka si mision hetimin, verifikimin edhe ndëshkimin e çdo rasti korruptiv, praktikave abuzive ose arbitrare, të cilat cenojnë të drejtat ligjore të qytetarëve apo kufizojnë e mohojnë aksesin e tyre në shërbimet publike, kjo me qëllim parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni në organet publike pjesë e Rrjetit kundër Korrupsionit, si dhe ndëshkimin e dërgimin para organeve të procedimit penal të personave përgjegjës. Gjithashtu, ky Rrjet nëpërmjet veprimtarisë së tij, synon të garantojë, ndër të tjera, forcimin e zbatueshmërisë së ligjit, rritjen e integritetit të administratës publike dhe garantimin e të drejtave të çdo qytetari në këtë drejtim.

Në zbatim të pikës 4, të vendimit nr. 606, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, të vendimit nr. 618, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”, i ndryshuar, si dhe Rregullores nr. 657, datë 01.12.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”, **Ministria e Drejtësisë publikon në faqen zyrtare të saj njoftimin për paraqitjen e shprehjeve të interesit për t’u zgjedhur/emëruar në pozicionin e koordinatorit në Institucionet pjesë e Rrjetit kundër Korrupsionit, përkatësisht për institucionet e përcaktuara në Aneks nr. 1, bashkëngjitur kësaj shpallje.**

1. Aplikanti që shpreh interesin për të aplikuar për pozicionin e Koordinatorit në institucionet pjesë të Rrjetit kundër Korrupsionit, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

❖ KRITERET E PËRGJITHSHME:

- a. të jetë shtetas shqiptar;
- b. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- ç. të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundërvajtje penale;
- d. të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- dh. të mos ketë çështje nën hetim/gjykim të nisur ndaj tyre.

❖ KRITERET E POSAÇME:

- a. Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare me diplomë “Master i Shkencave”;
- b. Të ketë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune.

❖ **KRITERI NDALUES:**

- a. Aplikanti nuk mund të aplikojë si koordinator pranë një institucioni, tek i cili ka qenë i punësuar për një periudhë mbi 3 muaj të njëpasnjëshëm gjatë 3 (tre) viteve të fundit.
2. Aplikanti duhet të dorëzojë, nëpërmjet shërbimit postar ose duke u paraqitur fizikisht pranë ambienteve të Ministrisë së Drejtësisë, aplikimin e tij. Dosja e aplikimit duhet të përmbajë dokumentet e listuara si më poshtë, në format origjinal ose të njehsuar me origjinalin (të noterizuar):
- Kërkesë me shkrim për shprehje interesi, duke specifikuar sipas rastit dhe institucionin/et përkatës/e ku shpreh interesin për tu emëruar;
 - CV (Jetëshkrim), i përditësuar;
 - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - Dëshmi penaliteti;
 - Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi nga institucioni/subjekti privat pranë të cilit rezultoi i punësuar;
 - Vërtetim nga organi i prokurorisë dhe gjykatës që nuk kanë çështje nën hetim/gjykim të nisur për personin e tyre/kundrejt tyre;
 - Diplomë e nivelit “Bachelor” dhe “Master Shkencor”. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
 - Libreza e punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
 - Deklaratën personale të nënshkruar lidhur me vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar;
 - Formularin e vetëdeklarimit (dekriminalizimit), sipas modelit bashkëlidhur Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
3. Mosdorëzimi i dokumentacionit të mësipërm përbën shkak për skualifikimin e aplikantit.
4. Aplikimi për shprehje interesi i paraqitur nga ana e subjekteve, kalon në dy faza vlerësimi, atë të verifikimit paraprak të dokumentacionit dhe intervistimit të kandidatit, ku në përfundim të procedurës së konkurrimit do të shpallet fitues çdo kandidat që vlerësohet me minimalisht 70 pikë nga 100.
5. Kandidatët që kanë shprehur kërkesë për shprehje interesi do të testohen në lidhje me:
- a. Vendimin nr. 618, datë 20.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”, i ndryshuar;
 - b. Kodi i Procedurave Administrative;

- c. Kodi Penal (Pjesa e Posaçme, Kreu III, Seksioni VIII “*Falsifikimi i dokumenteve*”, si dhe Kreu VIII, Seksioni I “*Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit*” dhe Seksioni II “*Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik*”);
 - d. Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”
 - e. Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
6. Afati për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për pozicionin e punës së Koordinatorit në institucionet pjesë e Rrjetit kundër Korrupsionit **është 7 ditë pune, nga shpallja në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.** Pas kalimit të këtij afati aplikimet e ardhura nuk merren në shqyrtim.
7. Lista me kandidatët fitues, në përfundim të procedurës së konkurrimit, publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, dhe çdo aplikant njoftohet në adresën e tij zyrtare elektronike dhe/ose me postë, lidhur me kualifikimin apo shkaqet e skualifikimit për shpalljen për të cilën ka konkurruar.
8. Komisioni vijon me thirrjen e kandidatëve, për propozimin e vendit vakant ku kandidati fitues është vlerësuar që të emërohet, duke respektuar, për aq sa është e mundur, preferencat e përzgjedhjes fillestare të këtyre kandidatëve.

Ankes 1

Nr.	Institucionet
1	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
2	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë
3	Operatori i Sistemit të Transmetimit
4	Posta Shqiptare
5	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Korçë
6	Spitali Universitar i Traumës